Në kontratën bazë të koncesionit të formës “BOT”, të nënshkruar nga palët: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Riviera” sh.p.k., “EHW” sh.p.k., “Energji Projekt” sh.p.k. dhe “Atlantik” sh.a., në datën 21 shtator 2012, me nr. 375 rep., nr. 203 kol., “Për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Mat: “Gjoni”, “Blishta”, “Klosi”, “Domi”, “Luci”, “Shoshaj”, “Zenishti” dhe “Burreli” pas titullit.

- Në paragrafin e dytë të kontratës dhe kudo në kontratë, togfjalëshi: “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës”, të zëvendësohet me togfjalëshin: “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”;

- Nga paragrafi i tretë deri te paragrafi i shtatë i kontratës, që përcakton Bashkimin e



Përkohshëm të Shoqërive “Riviera” sh.p.k., “EHW” sh.p.k., “Energji Projekt” sh.p.k. dhe “Atlantik” sh.a., në cilësinë e koncesionarit, si dhe cilësimet për secilën prej shoqërive të këtij bashkimi të përkohshëm, të zëvendësohet me paragrafin: shoqëria koncesionare “Mati Hydropower” sh.p.k., që në vijim do të quhet edhe “koncesionari”, shoqëri e regjistruar si person juridik në QKR, në datën 12.10.2012, me NIPT L22212004A, me seli të regjistruar në Tiranë, në adresën: rruga “Jul Variboba”, vila nr. 10, Tiranë, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor i saj znj. Aida Nani.

Neni 2

Në nenin 1, “Përkufizime dhe interpretime”, pika 1.5 zëvendësohet me paragrafin si më poshtë:

“1.5 Hidrocentralet: hidrocentralet “Mati 1”, “Mati 2”, “Mati 3”, me vendndodhje në lumin Mat dhe në përroi Xibër, Bashkia Mat, qarku Dibër, me fuqi të instaluar 38000 kw dhe prodhim të energjisë elektrike 134.700.000 kwh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalën e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbinë, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të.”.

Në pikën 1.8 dhe kudo në kontratë togfjalësh “Gjoni”, “Blishta”, “Klosi”, “Domi”, “Luci”, “Shoshaj”, “Zenishti” dhe “Burreli” zëvendësohet me “Mati 1”, “Mati 2”, “Mati 3”.

Neni 3

Në nenin 3 “Karakteristikat e hidrocentralit /eve” pika 3.1 ndryshohet si më poshtë:

“3.1 Hidrocentralet “Mati 1”, “Mati 2”, “Mati 3” do të ndërtohen në lumin e Matit dhe në përroi Xibër, Bashkia Mat, qarku Dibër, me këto karakteristika:

- Hidrocentrali Mati 1

- kuotat e veprave	
- kuota e veprës së marrjes lumi Mat	355 m
- kuota e godinës së centralit	270 m
- fuqia e instaluar	14.700 kw
- prodhimi vjetor i energjisë elektrike	50.000.000 kwh

- Hidrocentrali Mati 2

- kuotat e veprave	
- kuota e veprës së marrjes lumi Mat	248 m
- kuota e godinës së centralit	170 m
- fuqia e instaluar	14.800 kwh
- prodhimi vjetor i energjisë elektrike	58.600.000 kwh

- Hidrocentrali Mati 3

- kuotat e veprave	
- kuota e veprës së marrjes përroi Xibër	700 m
- kuota e godinës së centralit	261 m
- fuqia e instaluar	8,500 kwh
- prodhimi vjetor i energjisë elektrike	26.100.200 kwh.”.

Neni 4

Në nenin 4 “Periudha e koncesionit”, pas pikës 4.2.1 shtohet pika 4.2.2 me përmbajtjen si më poshtë:

“4.2.2 Palët, bien dakord që, në përfundim të periudhës së koncesionit, kjo marrëveshje mund të rinovohet, nëse një gjë e tillë parashikohet nga legjislacioni në fuqi në momentin e përfundimit të kësaj periudhe. Në këtë rast, secila nga palët që dëshiron të rinovojë këtë kontratë koncesionare, duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër, brenda një kohe të arsyeshme, por jo më pak se 3 vjet përpara përfundimit të periudhës së koncesionit, me qëllim që të zhvillohen bisedime paraprake për këtë qëllim.”.

Neni 5

Në nenin 5 “Të drejtat koncesionare – Sheshi”, pika 5.2.4 ndryshohet si më poshtë:

“5.2.4 Në lidhje me dhënien e Sheshit, të drejtës për kalim, gëzimit të qetë dhe së drejtës për akses dhe për të përdorur ujin e lumit Mat dhe përroi Xibër, koncesionari e pranon Sheshin “siç është” që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe autoriteti kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim, as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë pretendim përkundrejt koncesionarit, në lidhje me gjendjen e Sheshit.”.

Neni 6

Në nenin 8 “Detyrimet e koncesionarit”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 8.1 në shkronjën “b” paragrafi i dytë, ndryshohet si më poshtë:



“Koncesionari/shoqëria koncesionare është përgjegjëse për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë.”.

Pika 8.6 ndryshohet si më poshtë:

“8.6 Të zbatohet projektin final të zbatimit për ndërtimin e hidrocentraleve “Mati 1”, “Mati 2”, “Mati 3” me fuqi totale të vendosur në sasinë jo më pak se 38.000 kw.”.

Neni 7

Në nenin 9 “Vlerësimi i investimeve”, pika 9.1 ndryshohet si më poshtë:

“9.1 Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari do të jenë me vlerë totale jo më pak se 4,069,605,667 (katër miliardë e gjashtëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur, nga të cilat jo më pak se 1,013,483,387 (një miliardë e trembëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë do të investohen në makineri e pajisje.”.

Neni 8

Në nenin 10 “Programi i punimeve”, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 20 muajve nga data e lëshimit të lejes së zhvillimit dhe ndërtimit. Aplikimi për pajisjen me leje ndërtimi, do të kryhet brenda 60 ditëve nga data e miratimit të projektzbatimit përfundimtar nga autoriteti kontraktues.

2. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e fillimit të punimeve. Afati i ndërtimit është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në aneksin 2, bashkëlidhur.”.

Neni 9

Në nenin 12 “Zgjidhja e kontratës së Koncesionit” bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Në pikën 12.1 “Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga autoriteti kontraktues”, nën pikat 12.1.1. dhe 12.1.7 ndryshohen si më poshtë:

“12.1.1 Kur koncesionari nuk fillon punën (për shkak të tij) sipas afatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 10. Në këtë rast autoriteti kontraktues ka të

drejtë të marrë vlerën e sigurimit të kontratës të parashikuar në nenin 14.”.

“12.1.7. Kur nuk siguron financimin e projektit para afatit të fillimit të punimeve të përcaktuar në pikën 1, të nenit 10.”.

Në pikën 12.7, “Pagesat në rast zgjidhjeje të kontratës”, nën pika 12.7.1 ndryshohet si më poshtë:

“12.7.1 Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktues për faj të koncesionarit.

Në rast të zgjidhjes së kontratës për faj të koncesionarit, sipas nenit 12.1, autoriteti kontraktues i paguan koncesionarit, vetëm shumat e investuara sipas dokumenteve financiare (dokumentet financiare) deri në kufirin e investimit të realizuar në projekt.”.

Neni 10

Në nenin 14 “Sigurimi i kontratës”, në pikën 14.1 shifra “284,871,741 (dyqind e tetëdhjetë katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet e një)” zëvendësohet me “284.872.396 (dyqind e tetëdhjetë e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë)”.

Neni 11

Në nenin 15 “Sigurimet” pika 15.6, ndryshohet si më poshtë vijon:

“15.6 Autoriteti kontraktues, do të shënohet si palë e interesuar në të gjitha kontratat e sigurimit. Sigurimi do të mbulojë përgjegjësinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.”

Neni 12

Në nenin 22 “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve” pika 22.2 ndryshohet si më poshtë:

“22.2 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që lidhet me këtë kontratë koncesioni, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit, e cila do të funksionojë sipas rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (International Chamber of Commerce-ICC). Arbitrazhi do të zhvillohet në Zyrë, Zvicër. Gjykimi mund të bëhet me një grup prej 3 arbitrash, ku secila palë do të zgjedhë një arbitër dhe dy arbitrat do të zgjedhin arbitrin e tretë. Gjuha e procedimit do të jetë anglisht.”.



Neni 13

Në nenin 23 “Sanksionet”, paragrafi i parë i pikës 23.2 ndryshohet si më poshtë:

“23.2 Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 134.700.000 kwh/vit, koncesionari penalizohet me 5% të prodhimit të parealizuar për periudhën raportuese, duke pasur parasysh se në këtë rast autoriteti kontraktues do të marrë të plotë tarifën koncesionare. Në rast kur prodhimi nuk realizohet për shkaqe të tjera të ligjshme (jo për faj të koncesionarit), koncesionari nuk penali-zohet për prodhimin e munguar; ndërkaq, koncesionari është i detyruar të paguajë tarifën koncesionare, në vlerën prej 5% të prodhimit të realizuar. Megjithatë palët bien dakord se në rast të mosrealizimit të prodhimit të energjisë prej 134.700.000 kwh/vit, palët mund të ulen të negociojnë midis njëra-tjetrës.”

Neni 14

Në nenin 29, “Bashkëpunimi midis autoritetit kontraktues dhe koncesionarit”, paragrafi i katërt që përcakton adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, ndryshohet si më poshtë:

Për autoritetin kontraktues

Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
nr. 1001
Tiranë - Shqipëri

Për koncesionarin

Shoqëria “Mati Hydropower” sh.p.k.
Adresa: Rruga
“Jul Variboba”, nr. 10
Tiranë - Shqipëri
Tel: +355 (4) 45 00 765
Mob : +355 (68) 40 33 029
Email: aida.nani@enso.at

Neni 15

Kjo kontratë shtesë, hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët, dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë sipas përcaktimeve të nenit 48, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, të ndryshuar.

Kjo kontratë shtesë u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilat e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noteria e vërtetoj atë rregullisht.

AUTORITETI
KONTRAKTUES
MINISTRIA E ENERGISË
DHE INDUSTRIË
Përfaqësuar nga z. Koli Be

KONCESIONARI
“MATI HYDROPOWER”
SHPK
Përfaqësuar nga znj. Aida Nani

VENDIM

Nr. 532, datë 20.7.2016

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. DENIZ TUFINA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Deniz Tufina, në masën 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 533, datë 20.7.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION DHE RIKUALIFIKIM URBAN I LULISHTES PERËNDIMORE DHE SUPLEMENTI I SHESHIT QENDROR “TEODOR MUZAKA””, BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe rikualifikim urban i lulishtes perëndimore dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka””, Berat.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Berat.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 19 017 035 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 19 017 035 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Berat.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Berat, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

TABELA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTI “RIKONSTRUKSION DHE RIKUALIFIKIM URBAN I LULISHTES PERËNDIMORE (LOTI OPSIONAL) DHE SUPLEMENTI I SHESHIT QENDROR “TEODOR MUZAKA” (LOTI 3 PJESOR)

Nr.	Pronari		Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i ndërtimit	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera		Vlera gjithsej truall+ndërtesë
	emër	mbiemër				truall m ²	ndërtesë m ²	truall lekë	ndërtesë lekë	truall lekë	ndërtesë lekë	
1	Refat	Çobo	8502	11/153N1	Njësi	80	160	4183	situacion	334640	9173877,62	9508517.62
2	Shokic	Isufi	8502	11/153N2	Njësi	80	160	4183	situacion	334640	9173877,62	9508517.62
												19017035,24

VENDIM

Nr. 534, datë 20.7.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE TIRANË (KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS) SHITESA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private,

për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës) shitesa”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë,



sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “objekt”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 5 465 610 (pesë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekësh, nga të cilat:

- tokë “truall”, me sipërfaqe 20 m², me vlerë 615 660 (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë;

- “objekt”, me sipërfaqe 70 m², me vlerë 4 849 950 (katër milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “truall” dhe “objekte”, prej 5 465 610 (pesë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I “UNAZA E MADHE E TIRANËS”

SEGMENTI KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS) SHITESA

Nr. rendor	PRONARI			Z. kadastrale	Nr. pasurie	VLERA E SHPRONËSIMIT			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	ATËSIA	MBIEMRI			Sip. Truall (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
	Mevlude Agolli			8260	1/54+1-1	13	30,783	400,179	400,179	Kufizim nga ZVRPP-ja
	Mevlude Agolli			8260	1/54+1-2	7	30,783	215,481	215,481	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	SHUMA					20		615,660	615,660	

likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



LISTA E PRONARËVE PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI
I “UNAZA E MADHE E TIRANËS”
SEGMENTI KOMUNA E PARISIT–RRUGA E KAVAJËS) (SHITESA OBJEKTET)

Nr. rendor	PRONARI			Z. kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqja e objekteve (banesë) m ²	Çmimi mesatar(l/m ²)	Vlera sipas çmimit mesatar (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Shefike Genc Valbona	Shyqyri Ahmet Ahmet	Imeri Imeri Seferi	8260	1/275/ ND	70	69,285	4,849,950	4,849,950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja nr. 13296/1, datë 18.5.2016
	SHUMA					70		4,849,950	4,849,950	

VENDIM

Nr. 5813, datë 15.7.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 22, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” të kreut VII, nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 20.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

VENDOSA:

1. Z. Ergys Qirici, me detyrë drejtor i përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të ushtrojë përkohësisht kompetencat ligjore të Sekretarit të Përgjithshëm, duke përfshirë dhe kompetencat e titullarit të autoritetit kontraktor deri në datën e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm në ministri.

2. Data e fillimit të kompetencave të deleguara është data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Autorizimi nr. 3583, prot., datë 4.5.2016 dhe çdo akt që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

URDHËR

Nr. 3762, datë 18.7.2016

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 13, datë 8.6.2016, të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave me ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Ky urdhër hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, urdhri nr. 1827, datë 16.3.2008, për miratimin e rregullores “Për kompensimin e depozitave”, shfuqizohet.

GUVERNATORI I BANKËS SË
SHQIPËRISË
Gent Sejko

**RREGULLORE****PËR KOMPENSIMIN E DEPOZITAVE TË
SIGURUARA****KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:

a) rregullave të përgjithshme në lidhje me fazat, mënyrat dhe afatet për kompensimin e depozitave të siguruara;

b) rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave dhe shërbimeve nga Agjencia për të përmbushur funksionet e saj në rast të kompensimit të depozitave;

c) marrëdhënieve ndërmjet subjekteve pjesëmarrëse në procesin e kompensimit të depozitave.

Neni 2**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje dhe zbatim të neneve 1, pika 2, neneve 11, 38, 39, 40, 41, 42, pika 7, 44, pika 2, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, si dhe të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3**Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe SHKK-të, likuidatori, subjektet në likuidim të detyruar, bankat agente dhe subjektet mbështetëse të kontraktuara nga Agjencia për kryerjen e procesit të kompensimit.

Neni 4**Përkufizimi i termave**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim me përcaktimet e ligjit “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

2. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë kuptim si vijon:

a) Bankë agente është banka anëtare e skemës së sigurimit të depozitave, e cila përzgjidhet nga Këshilli Drejtues i Agjencisë për kryerjen e procesit të kompensimit, në emër dhe për llogari të Agjencisë si agjent pagese.

b) Subjekt nën likuidim të detyruar është subjekti, i cili i nënshtrohet procesit të likuidimit të detyruar sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për shoqëritë e kursim kreditit”.

c) Subjekt mbështetës është individ, personi fizik tregtar apo juridik, i cili përzgjidhet nga Agjencia për kryerjen e shërbimeve dhe ofrimin e mallrave për përgatitjen dhe zbatimin e procesit të kompensimit.

ç) Paraqitja unike e depozituesve “Single Customer View” janë të dhënat e konsoliduara për identifikimin e çdo depozituesi në mënyrë unike në sistemin informatik të subjektit anëtar të skemës, nëpërmjet të dhënave personale të një depozituesi konkret, ku përcaktohet saktë shuma e kompensimit që përfiton ky depozitues.

d) Listë pagesa është dokumenti i dorëzuar nga likuidatori, që përmban paraqitjen unike të depozituesve që përfitojnë kompensim dhe shumat përkatëse për kompensim nga Agjencia dhe që pas kontrollit nga Agjencia i dërgohet bankës agente.

dh) Detyrimet e papaguara në kohë janë detyrimet e depozituesve kundrejt subjektitanëtar të skemës, të përlllogaritura nga dita e nesërme e datës së maturimit të tyre.

e) Përfaqësuesi i depozituesit është personi i autorizuar me prokurë ose nga ligji, trashëgimtari i depozituesit, ose çdo individ tjetër, që në bazë të tagrave ligjore paraqitet për të përfituar kompensimin e depozitës.

ë) Simulim është procesi i testimi të aftësisë të Agjencisë, të subjekteve të skemës të sigurimit të depozitave dhe të subjekteve mbështetëse për kryerjen e procesit të kompensimit.

f) “Sistemi informatik për raportim dhe kompensim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në pikën 4, të nenit 26, të ligjit “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, dhe këtu e në vijim do të referohet si “SIRK”.

3) Titujt dhe krerët në këtë rregullore janë përdorur vetëm për orientim e referim dhe nuk kanë për qëllim të kushtëzojnë ose të kufizojnë interpretimin e përcaktimeve dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

4. Në këtë rregullore, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjellas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e dispozitës.



5. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjelltas.

KREU II PËRGATITJA PËR KOMPENSIM GJATË VEPRIMTARISË SË PËRDITSHME

Neni 5 Burimet njerëzore

1. Agjencia ka të drejtë të punësojë personel shtesë, me kontratë me afat, pa procedurë konkurrimi, të cilët mund të jenë punonjës të Autoritetit Mbikëqyrës, të bankës agjente, specialistë nga institucionet homologe, si dhe ekspertë ndërkombëtarë.

2. Agjencia kryen trajnime të vazhdueshme të burimeve njerëzore të saj, bankës agjente, si dhe subjekteve mbështetëse, për zbatimin e saktë dhe në kohë të procesit të kompensimit.

Neni 6 Teknologjia e informacionit

1. Agjencia krijon, përshtat dhe mirëmban SIRK me qëllim kompensimin e shpejtë dhe të saktë të depozitave.

2. Subjektet anëtare të skemës plotësojnë kushtet për listë pagesën me paraqitjen unike të depozituesit “Single Customer View”, sipas formatit standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe marrin pjesë në simulime për këtë qëllim.

3. Subjektet anëtare raportojnë paraqitjen unike të depozituesit “Single Customer View” brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e Agjencisë.

Neni 7 Mjaftueshmëria e mjeteve financiare

1. Agjencia harton strategjinë për sigurimin e mjeteve likuide të nevojshme sipas subjektit anëtar përkatës dhe kryen analizën për kostot e procesit të kompensimit, si dhe të mënyrave të kryerjes së tij.

2. Strategjia për sigurimin e mjeteve likuide të nevojshme është subjekt simulimi.

Neni 8 Informimi i publikut dhe komunikimi me depozituesit

1. Agjencia harton strategjinë për informimin e publikut dhe komunikimin me depozituesit.

2. Autoriteti Mbikëqyrës dhe Agjencia krijojnë strategji të përbashkëta komunikimi për skenarë të ndryshëm të ngjarjeve të sigurimit.

3. Strategjitë e komunikimit, janë subjekt i simulimeve të përbashkëta midis Autoritetit Mbikëqyrës dhe Agjencisë.

Neni 9 Përzgjedhja e bankës agjente dhe subjekteve mbështetëse

1. Agjencia kryen procedurat e përzgjedhjes të bankës agjente dhe subjekteve mbështetëse në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje, si dhe kryen simulime me to për përmbushjen e funksioneve të tyre gjatë procesit të kompensimit.

2. Subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave i raportojnë Agjencisë me kërkesë të saj, kontratat që ato kanë me operatorë të ndryshëm, që ofrojnë shërbime mbështetëse.

Neni 10 Verifikime në subjektet anëtare të skemës

Agjencia verifikon në subjektet anëtare:

a) mbajtjen e të dhënave për depozitat dhe depozituesit në subjektin anëtar të skemës;

b) nxjerrjen e listëpagesës me paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View”;

c) nxjerrjen e listës së depozituesve, që për shkaqe sociale mund të përfitojnë pagesa paraprake dhe të pjesshme të kompensimit.

Neni 11 Bashkëveprimi i Autoritetit Mbikëqyrës me Agjencinë

1. Autoriteti Mbikëqyrës informon Agjencinë, në rast të rrethanave që mund të shkaktojnë ngjarje sigurimi me qëllim marrjen e masave përgatitore për kryerjen e kompensimit të depozitave brenda një afati të arsyeshëm.

2. Autoriteti Mbikëqyrës, ndër të tjera:

a) fton punonjës të Agjencisë, në rast të kryerjes së inspektimeve në subjekt;

b) siguron pjesëmarrjen e Agjencisë në grupet e punës të ngritura në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;

c) konsultohet me Agjencinë për kryerjen e vlerësimit të kostove së kompensimit të depozitave për të përcaktuar domosdoshmërinë e kryerjes së kompensimit nëpërmjet pagesës së depozitave apo transferimit të mjeteve financiare të Agjencisë;



ç) i jep Agjencisë të dhëna mbi gjendjen financiare të bankave me qëllim përzgjedhjen e bankës agjente;

d) shqyrton për miratim brenda 7 ditëve, propozimin e Agjencisë për mbledhjen e primit përpara afatit, rritjen e tij dhe mbledhjen e kontributit të jashtëzakonshëm.

KREU III

PROCESI I KOMPENSIMIT

Neni 12

Fazat e procesit të kompensimit

1. Procesi i kompensimit realizohet nëpërmjet tri fazave:

a) përgatitjet paraprake për kompensimin e depozitave;

b) kryerja e pagesave të kompensimit të depozitave; dhe

c) mbyllja e procesit të kompensimit.

2. Agjencia miraton akte të brendshme për organizimin e punës në Agjenci për kompensim.

Neni 13

Përgatitjet paraprake për kompensimin e depozitave

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë autorizon drejtorin e përgjithshëm për kryerjen e procedurave të përgatitjes për kompensimin e depozitave, me marrjen e informacionit nga Autoriteti Mbikëqyrës sipas nenit 11, pika 1, të kësaj rregulloreje, ose në çdo rast tjetër kur e gjykon të arsyeshme nisur nga kushtet e tregut.

2. Kjo fazë zgjat deri në momentin kur nis kryerja e pagesave të kompensimit.

3. Drejtori i përgjithshëm, me marrjen e autorizimit nga Këshilli Drejtues, zbaton masat vijuese për përgatitjen paraprake për kompensim, por pa u kufizuar:

a) verifikon mbajtjen e të dhënave për depozitat dhe depozituesit në subjekt;

b) i kërkon subjektit të mundësojë listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View” dhe ta përmirësojë atë sipas formatit standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë;

c) i kërkon subjektit të mundësojë listën e depozituesve, që për shkaqe sociale mund të përfitojnë pagesa paraprake dhe të pjesshme të kompensimit;

ç) rishikon strategjinë për sigurimin e mjeteve likuide, të nevojshme sipas subjektit përkatës, me synim optimizimin e kostove dhe respektimin e afateve ligjore të kompensimit;

d) kryen analizën për kostot e procesit të kompensimit, si dhe të mënyrave të kryerjes së tij në zbatim të nenit 14, pika 3, të kësaj rregulloreje;

dh) rishikon strategjinë për informimin e publikut;

e) verifikon përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe teknike nga bankat agjente dhe merr ofertat ekonomike për caktimin e bankës agjente;

ë) merr oferta ekonomike nga subjektet mbështetëse;

f) analizon mjaftueshmërinë e burimeve njerëzore dhe merr masa për plotësimin dhe trajnimin e tyre;

g) bashkëpunon me Autoritetin Mbikëqyrës dhe Ministrinë e Financave për zbatimin e procesit të kompensimit;

gj) propozon rishikimin e kuadrit rregullativ dhe rishikon aktet e brendshme, në rast se konsiderohet e nevojshme.

Neni 14

Kompensimi i depozitave

1. Me marrjen e njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit në likuidim të detyruar, Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton aktet e brendshme për kompensimin e depozitave, në veçanti përzgjedhjen e bankës agjente, si dhe rishikimin e buxhetit, përfshirë përdorimin e mjeteve financiare të investuara.

2. Agjencia brenda njëzet ditëve pune nga marrja e njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni, fillon kryerjen e pagesave të kompensimit të depozitave.

3. Mënyrat e pagesës së kompensimit, përveç atyre të parashikuara në ligjin “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, janë:

a) pagesa nëpërmjet shërbimit postar;

b) pagesa nëpërmjet ATM-ve; ose

c) kombinimi i mënyrave të lejuara të pagesës.

Neni 15

Dërgimi i listëpagesës

1. Likuidatori dërgon në Agjenci listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View” brenda 2 ditëve nga vendosja e subjektit në likuidim të detyruar. Dërgimi i listëpagesës në Agjenci kryhet nëpërmjet



ngarkimit të të dhënave në SIRK sipas formatit standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, si dhe me shkresë të shoqëruar me mjete elektronike.

2. Listëpagesa, sipas pikës 1 të këtij neni, përmban vlerën neto të depozitave që kompensohen deri në nivelin maksimal të mbulimit, nga e cila janë zbritur të gjitha detyrimet sipas ligjit “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, përfshirë ato tatimore të pagueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkimi i të dhënave në SIRK shoqërohet me dërgimin e deklaratës së përputhshmërisë të përcaktuar në aneksin 2 të kësaj rregulloreje. Kjo deklaratë nënshkruhet nga likuidatori dhe personat përgjegjës të ngarkuar për hartimin e listë pagesës.

4. Agjencia kryen kontrollin e të dhënave të ngarkuara në SIRK, të cilat klasifikohen në tri grupe:

- të dhëna tërësisht të përputhshme dhe të gatshme për pagesë;
- të dhëna pjesërisht të përputhshme dhe të dyshuara;
- të dhëna të pasakta dhe të bllokuara.

5. Pastrimi i të dhënave kryhet për të identifikuar të dhënat me cilësi të papërpunueshme, siç mund të jenë gabime shkrimi, të dhëna personale të dublikuara apo parregullsi të tjera.

6. Të dhënat tërësisht të përputhshme dhe të gatshme për pagesë, verifikohen nëpërmjet SIRK-së, sipas akteve të miratuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë.

7. Të dhënat e vlerësuara si tërësisht të përputhshme dhe të gatshme për pagesë, miratohen nga strukturat përkatëse të Agjencisë sipas akteve të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe përfshihen në një listë pagesë, të konsoliduar për çdo depozitues.

8. Listëpagesa e saktë dhe e konsoliduar për kompensimin e depozituesve të siguruar, e shoqëruar me shkresë dhe në mënyrë elektronike, i dërgohet bankës agjente ose subjektit në likuidim, sipas mënyrës së kompensimit.

9. Pjesa e mbetur e të dhënave i kthehen likuidatorit për saktësime përkatëse.

10. Likuidatori korrigjon të dhënat e pasakta, të paplota, të rreme apo të falsifikuara dhe i

ngarkon ato në të njëjtën mënyrë sipas përcaktimeve të këtij neni dhe afatit të përcaktuar nga Agjencia.

Neni 16

Bashkëpunimi me likuidatorin

1. Në procesin e kompensimit likuidatori bashkëpunon me Agjencinë në lidhje me:

- a) kryerjen e kompensimit nëpërmjet subjektit nën likuidim të detyruar dhe/ose bankës agjente;
- b) shqyrtimin e ankesave të depozituesve në lidhje me kompensimin e depozitave;
- c) informimin e punonjësve të subjektit nën likuidim të detyruar dhe depozituesve për kompensimin e depozitave;
- ç) mbrojtjes të interesave të Agjencisë për mbulimin e shpenzimeve dhe shumave të paguara prej saj nga procesi i likuidimit.

2. Likuidatori plotëson kushtet për paraqitjen unike të depozituesit “Single Customer View”, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje.

3. Likuidatori i dërgon Agjencisë informacionin e parashikuar në ligjin për sigurimin e depozitave, të ndryshuar, si dhe çdo informacion të kërkuar prej saj, në veçanti, në lidhje me:

- a) pasqyrat kontabël dhe statistikore për veprimet me depozitat gjatë tre muajve të fundit përpara vendosjes së subjektit në likuidim;
- b) të dhëna mbi mashtrimet me depozitat apo depozitat e përdorura për qëllime të pastrimit të parasë ose financimit të terrorizmit;
- c) të dhëna mbi pikat e subjektit nën likuidim të hapura për kompensimin e depozitave dhe regjimin e tyre të punës në rast se kompensimi i depozitave kryhet në subjektin e vendosur në likuidim;

ç) të dhëna mbi pagesat e kryera të kompensimit përfshirë pagesat paraprake dhe të pjeshme nëse ka, si dhe bilancin e depozitave të papaguara, në rast se kompensimi i depozitave kryhet në subjektin e vendosur nën likuidim;

d) të dhëna mbi punonjësit e subjektit nën likuidim dhe subjektet mbështetëse që kanë lidhje me kompensimin e depozitave;

dh) njofton Agjencinë për çdo ankesë që mund t'i paraqitet nga depozituesit lidhur me kompensimin e depozitave, si dhe mbështet atë për shqyrtimin e saj.

4. Në rastet kur konstatohet se kompensimi është kryer mbi të dhëna të pavërteta dhe të



pasakta, likuidatori i rimbursos Agjencisë shumë e kompensuar gabimisht.

5. Kur kompensimi kryhet nga banka agjente, Agjencia informon likuidatorin për depozituesit e kompensuar.

Neni 17

Marrëdhënia me bankën agjente

1. Drejtori i përgjithshëm nënshkruan autorizimin për kompensimin e depozitave, që i dërgohet bankës agjente, sipas kreut IV të kësaj rregulloreje.

2. Agjencia i dërgon bankës agjente listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View”, sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, të shoqëruar me shkresë dhe në mënyrë elektronike.

3. Agjencia i transferon bankës agjente mjetet likuide për kompensimin e depozitave, si dhe paguan për ofrimin e këtij shërbimi sipas shumave të negociuara me të, përveç rastit kur ky shërbim ofrohet falas.

4. Banka agjente i raporton Agjencisë sipas kërkesave të saj dhe në përputhje me kushtet edhe dokumentet tip, të parashikuara në kontratën e agjencisë, në veçanti, për:

a) shumat dhe numrin e depozituesve që kanë përfituar nga kompensimi;

b) shumat dhe numrin e depozituesve që kanë mbetur për t'u kompensuar.

5. Për çështje që nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë rregullore dhe në kontratën e kompensimit të depozitave, palët veprojnë në përputhje me ligjin “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 18

Informimi i publikut dhe komunikimi me depozituesit

1. Agjencia informon publikun dhe komunikon me depozituesit për fillimin, ecurinë dhe përfundimin e procesit të kompensimit.

2. Mënyrat e informimit dhe komunikimit janë, por pa u kufizuar:

a) konferenca për shtyp;

b) publikime, komunikime në media;

c) njoftime në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë;

ç) komunikime nëpërmjet linjave telefonike falas dhe pa pagesë dhe qendrave telefonike;

Faqe | 11306

d) komunikime nëpërmjet profileve elektronike të Agjencisë në rrjetet sociale.

Neni 19

Procedurat e pagesës

1. Depozituesi, për të përfituar kompensimin e depozitës, paraqet dokumentacionin identifikues sipas aneksit 3 të kësaj rregulloreje.

2. Procedura e pagesës së shumës së kompensimit kryhet në përputhje me aneksin 3 të kësaj rregulloreje dhe kontratën për kompensimin e depozitave.

Neni 20

Pretendimet e depozituesve

1. Çdo depozitues, që përfiton kompensim nga skema e sigurimit të depozitave, mund të paraqesë pretendimet e tij duke plotësuar dokumentet tip, të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

2. Ankesa mund të paraqitet brenda gjashtëdhjetë ditëve kalendarike nga marrja e refuzimit të kompensimit të depozitave.

3. Pagesat e kompensimit refuzohen nëse:

a) të dhënat identifikuese të paraqitura, si dhe shuma e depozitës të pretenduar nuk përputhen me të dhënat e listëpagesës;

b) në listëpagesë nuk është i përfshirë pretenduesi i shumës së sigurimit.

4. Agjencia i jep likuidatorit të dhënat mbi pretendimet e paraqitura në bankën agjente dhe merr të dhëna për ankesat e paraqitura nga depozituesit në subjektin e vendosur në likuidim të detyruar.

5. Në rast se kompensimi i depozitave kryhet në subjektin e vendosur në likuidim të detyruar, likuidatori mban të dhëna të konsoliduara mbi ankesat e depozituesve të paraqitura tek ai dhe informon Agjencinë në lidhje me to sipas kërkesës së saj.

6. Agjencia dhe likuidatori, shqyrtojnë pretendimet e depozituesve së bashku me dokumentacionin mbështetës të paraqitur prej tyre. Likuidatori korrigjon të dhënat e listë pagesës sipas vendimit të Agjencisë për pretendimet dhe ia dërgon atë asaj në të njëjtën mënyrë sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje.

7. Në rast se për vlerësimin e ankesës gjykohej se duhet të paraqiten dokumente dhe fakte të



tjera që vërtetojnë pretendimin për kompensimin e depozitës, depozituesi i paraqet ato brenda 8 ditësh pune nga njoftimi i Agjencisë.

8. Çdo depozitues ka të drejtën të ankimojë vendimin e Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës brenda 15 ditëve kalendarike nga data e vendimit të Agjencisë.

Neni 21

Mbyllja e procesit të kompensimit

1. Në përfundim të afatit ligjor të kompensimit, Këshilli Drejtues i Agjencisë merr vendime për mbylljen e këtij procesi sipas akteve të brendshme të Agjencisë.

2. Këshilli Drejtues i Agjencisë analizon ecurinë e procesit të kompensimit nëpërmjet raportimeve të subjekteve të përfshira në të, si dhe miraton planin e masave për përmirësimin e këtij procesi.

3. Në përfundim të procesit të kompensimit Agjencia kryen njoftimin e depozituesve që nuk janë paraqitur brenda afatit të kompensimit.

KREU IV

PËRZGJEDHJA E BANKAVE AGJENTE DHE SUBJEKTEVE MBËSHTETËSE

Neni 22

Fazat e përzgjedhjes së bankave agjente dhe subjekteve mbështetëse

1. Në zbatim të nenit 42, pika 7, të ligjit për sigurimin e depozitave i ndryshuar, përzgjedhja e bankave agjente bëhet në dy faza:

a) Faza e parë - vlerësimi i bankave anëtare të skemës sipas kriterëve të përgjithshme dhe teknike dhe nënshkrimi i kontratave për kryerjen e kompensimit të depozitave me bankat e përzgjedhura në listën paraprake. Kjo fazë realizohet gjatë veprimtarisë së përditshme sipas kreut II të kësaj rregulloreje. Lista paraprake përbëhet nga jo më shumë se tri banka anëtare të cilat përmbushin kriteret e përgjithshme dhe marrin nga vlerësimi i kriterëve teknike pikët më të larta sipas rendit zbritës, sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje.

b) Faza e dytë - vlerësimi i ofertave ekonomike nga bankat e përzgjedhura në listën paraprake gjatë përgatitjes paraprake sipas nenit 12, pika 1, shkronja “a” të kësaj rregulloreje dhe dërgimi i autorizimeve për kryerjen e kompen-

simit të depozitave bankës agjente të shpallur fituese, pas njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit në likuidim të detyruar.

2. Në rast pamundësie për të kryer procedurat për përzgjedhjen e bankës agjente, Këshilli Drejtues i Agjencisë, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, vendos për nënshkrimin e kontratës në mënyrë të drejtpërdrejtë me një bankë nga bankat anëtare të skemës. Në këtë rast, Këshilli Drejtues mund të kërkojë opinionin zyrtar të Autoritetit Mbikëqyrës për përzgjedhjen e bankës agjente në mënyrë të drejtpërdrejtë.

3. Në zbatim të nenit 42, pika 7, të ligjit për sigurimin e depozitave, i ndryshuar, përzgjedhja e subjekteve mbështetëse kryhet gjatë periudhës së përgatitjes për kompensim në veprimtarinë e përditshme sipas kreut II, si edhe në procesin e kompensimit sipas kreut III të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Kompetencat për përzgjedhjen e bankave agjente

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë përzgjedh çdo tre vjet bankat agjente nga bankat anëtare të skemës për sigurimin e depozitave.

2. Këshilli Drejtues i Agjencisë krijon një komision të përhershëm vlerësimi për përzgjedhjen e bankave agjente. Në këtë vendim përcaktohet edhe kryetari i komisionit.

3. Komisioni i përhershëm i vlerësimit përbëhet nga 5 persona si vijon: një anëtar i Këshillit Drejtues të Agjencisë, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë, një përfaqësues i Autoritetit Mbikëqyrës dhe punonjës të Agjencisë. Në të mund të përfshihen edhe specialistë/ekspertë të fushës. Autoriteti Mbikëqyrës, me kërkesë të komisionit të përhershëm të vlerësimit, paraqet opinionin zyrtar për gjendjen financiare të bankave anëtare të skemës, i cili përfshin të dhëna jo më të hershme se tre muaj nga data e zhvillimit të vlerësimit.

Neni 24

Faza e parë - përzgjedhja e bankave në listën paraprake

1. Përzgjedhja e bankave anëtare në listën paraprake kryhet gjatë periudhës së përgatitjes për kompensim në veprimtarinë e përditshme sipas kreut II të kësaj rregulloreje. Kjo fazë fillon



me dërgimin e ftesës bankave anëtare të skemës dhe përfundon me marrjen e vendimit nga Këshilli Drejtues i Agjencisë për përzgjedhjen e bankave në listën paraprake.

2. Këshilli Drejtues i Agjencisë autorizon Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit për fillimin e procedurave sipas këtij neni.

3. Drejtori i përgjithshëm nënshkruan ftesën që i dërgohet të gjithave bankave anëtare të skemës. Ftesat shoqërohen me kriteret e përgjithshme dhe teknike të kualifikimit, udhëzime, kushtet e kontratës për kryerjen e kompensimit të depozitave, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.

4. Vlerësimi i bankave anëtare të skemës nga komisioni i përhershëm kryhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

5. Këshilli Drejtues shqyrton raportin e komisionit të përhershëm të vlerësimit dhe merr vendim për nënshkrimin e kontratës për kryerjen e kompensimit të depozitave me jo më shumë se tri bankat anëtare të renditura të parat në klasifikim.

6. Kontratat nënshkruhen me tri bankat anëtare të cilat, vlerësohen se:

- a) përmbushin kriteret e përgjithshme; dhe
- b) marrin pikët më të larta për përmbushjen e kriterëve teknike sipas rendit zbritës.

7. Aktet e Këshillit Drejtues të Agjencisë për përzgjedhjen e bankave agjente janë përfundimtare dhe nuk mund të ankimohen.

Neni 25

Nënshkrimi i kontratave me bankat e përzgjedhura në listën paraprake

1. Kontratat për kryerjen e kompensimit nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Këshillit Drejtues për përzgjedhjen e bankave në listën paraprake.

2. Afati i kontratave është 1-vjeçar (njëvjeçar) dhe me të drejtë rinovimi njëvjeçarë edhe për 2 (dy) vjet pasuese.

3. Drejtori i përgjithshëm miraton dhe nënshkruan kontratën tip për kryerjen e kompensimit të depozitave me bankat agjente, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet e ofrimit të shërbimit, si dhe dokumentet udhëzuese për kryerjen e tij.

4. Bankat e përzgjedhura në listën paraprake, me të cilat janë nënshkruar kontratat për kryerjen e kompensimit të depozitave, rivlerësohen çdo vit nga komisioni i përhershëm i vlerësimit për përputhshmërinë me kriteret e përgjithshme dhe teknike.

5. Kontrata konsiderohet e rinovuar edhe për 1 (një) vit, nëse banka me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe teknike.

6. Agjencia merr masa për përzgjedhjen e bankave agjente në listën paraprake, 6 muaj përpara përfundimit të kontratave në fuqi me bankat e përzgjedhura në listë.

Neni 26

Faza e dytë – vlerësimi i ofertave ekonomike

Përzgjedhja e bankës agjente në ngjarjen e sigurimit

1. Përzgjedhja e bankës agjente nga lista paraprake kryhet kur Këshilli Drejtues i Agjencisë autorizon Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit për fillimin e procedurave sipas këtij neni. Në këtë vendim përcaktohet edhe fondi limit i pagesës së bankës agjente për shërbimin e ofruar, sipas propozimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit. Ky fond është i zbatueshëm nëse asnjë nga ofertat që do të paraqiten nga bankat e përzgjedhura nuk përfaqësojnë ofrimin e shërbimit falas.

2. Kjo fazë fillon me dërgimin e kërkesës për ofertë ekonomike bankave të përfshira në listën paraprake dhe përfundon me marrjen e vendimit nga Këshilli Drejtues i Agjencisë për përzgjedhjen e bankës agjente fituese.

3. Komisioni i përhershëm i vlerësimit përpara marrjes së ofertave ekonomike, nëse e gjykon të arsyeshme, mund të verifikojë përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe teknike nga bankat e përfshira në listën paraprake sipas pikës 6, të nenit 24, të kësaj rregulloreje.

4. Drejtori i përgjithshëm nënshkruan kërkesën për ofertë që i dërgohet bankave të përfshira në listën paraprake.

5. Komisioni i përhershëm i vlerësimit, nëse e gjykon të arsyeshme, kryen negociime me bankat për sqarimin dhe përmirësimin e kushteve të kontratës; të mënyrave të kalimit të mjeteve monetare të Agjencisë; të listës së degëve dhe



pikave të pagesës të bankës; si dhe të metodologjisë së kryerjes të shërbimit dhe përbërjen e stafit, i cili do të marrë pjesë në procesin e kompensimit.

6. Bankat paraqesin ofertat ekonomike për shërbimin e kompensimit të depozitave brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e komisionit të përhershëm të vlerësimit.

7. Komisioni i përhershëm i vlerësimit i paraqet për shqyrtim Këshillit Drejtues raportin e vlerësimit, në të cilin klasifikohen sipas rendit zbritës ofertat e paraqitura. Banka që vlerësohet se ka paraqitur ofertën ekonomikisht më të favorshme sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje, renditet e para.

8. Këshilli Drejtues merr vendim për përzgjedhjen e bankës agente vetëm pasi njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit në likuidim të detyruar. Ky vendim përcakton mënyrën e pagesës së kompensimit, pagesën e bankës agente (nëse ka), mënyrën e kalimit të mjeteve monetare të Agjencisë për kompensimin e depozitave etj.

9. Këshilli Drejtues kur e vlerëson të arsyeshme mund të përzgjedhë më shumë se një bankë agente nga lista paraprake.

10. Bankës/ve agente fituese i dërgohet autorizimi për kompensimin e depozitave, jo më vonë se dita e nesërme e punës nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues.

11. Vendimi i Këshillit Drejtues për përzgjedhjen e bankës/ave agente hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

12. Në rast se banka/at agente fituese shkel kushtet e kontratës ose tërhiqet, Këshilli Drejtues i Agjencisë merr vendim për zëvendësimin e saj, duke përzgjedhur bankën agente që renditet e dyta në vlerësimin përfundimtar.

Neni 27

Përzgjedhja e subjekteve mbështetëse

1. Subjekte mbështetëse që ofrojnë shërbime dhe mallra për përgatitjen dhe kompensimin e depozitave mund të jenë: shërbime për zhvillim dhe mirëmbajtje të SIRK-së dhe platforma të tjera elektronike; shërbime kontabiliteti dhe mbështetje për veprimet me listëpagesën e kompensimit, shërbime auditimi, shërbime ligjore; qendër thirrjesh telefonike (*call center*);

shërbime konsulence profesionale; shërbime financiare; shërbime vlerësimi për rimarrje, shërbime ndërmjetësimi dhe pajtimi, shërbime të ruajtjes fizike.

2. Njësitë organizative të Agjencisë i paraqesin drejtorit të përgjithshëm propozimin për kontraktimin e subjekteve mbështetëse nëpërmjet studimit të tregut mbi vlerat limit të kontratave, specifikimet teknike, termat e referencës dhe kriteret e kualifikimit. Përcaktimi i fondit limit bazohet në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH në tregun vendas dhe nëse gjykohet e nevojshme në shumën e pagueshme nga skemat homologe të sigurimit të depozitave.

3. Drejtori i përgjithshëm, bazuar në propozimin e njësive organizative të Agjencisë, i kërkon Këshillit Drejtues dhënien e autorizimit për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e subjekteve mbështetëse. Vendimi i Këshillit Drejtues përcakton kategoritë e subjekteve mbështetëse për të cilat do të kryhen procedurat e përzgjedhjes dhe fondet limite përkatëse për çdo kontratë.

4. Këshilli Drejtues me propozim të drejtorit të përgjithshëm vendos për marrjen e shërbimeve dhe mallrave sipas pikës 1 të këtij neni, nga subjektet që janë ose kanë qenë të kontraktuara nga Agjencia, pa kryer procedurat e përzgjedhjes, kur gjykohet se përmbushja e detyrimeve prej tyre ka qenë e kënaqshme.

5. Subjektet që ofrojnë mallra dhe/ose shërbime të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni (mirëmbajtje, kancelari, transport, konferenca, karburant, shërbime postare, trajnime, akomodime stafi, tryeza të rrumbullakëta, linja telefonike pa pagesë, materiale informative dhe promocionale etj.), kontraktohen drejtpërdrejt me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, sipas propozimit të sektorit përkatës të Agjencisë, në procesin e kompensimit sipas kreut III të kësaj rregulloreje.

Neni 28

Vlerësimi i subjekteve mbështetëse

1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë krijon një njësi vlerësimi të subjekteve mbështetëse të përcaktuara në pikën 1, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, përveç për rastet në të cilat zbatohet pika 4, e nenit 27, të kësaj rregulloreje. Kjo njësi përbëhet nga 3 persona dhe mund të përbëhet



nga punonjës të Agjencisë dhe/ose specialistë/ ekspertë të fushës.

2. Njësia e vlerësimit i dërgon ftesën për ofertë jo më shumë se 3 (tri) subjekteve mbështetëse të së njëjtës natyrë. Ftesat shoqërohen me kriteret e kualifikimit, udhëzimet, kushtet e kontratës, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm.

3. Vlerësimi i subjekteve mbështetëse nga njësia e vlerësimit kryhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aneksin 4 të kësaj rregulloreje.

4. Njësia e vlerësimit harton raportin në të cilin subjektet që përmbushin kriteret e kualifikimit klasifikohen sipas rendit zbritës të ofertave të paraqitura. Subjekti që ka ofruar çmimin më të ulët renditet i pari.

5. Drejtori i përgjithshëm shqyrton raportin e njësies të vlerësimit dhe urdhëron nënshkrimin e kontratës me subjektin fitues për çdonjërin nga kategoritë.

6. Drejtori i përgjithshëm miraton dhe nënshkruan kontratën tip për kryerjen e shërbimeve dhe ofrimin e mallrave, nëse ka, me subjektet mbështetëse.

7. Urdhrat e drejtorit të përgjithshëm për përzgjedhjen e subjekteve janë përfundimtare dhe nuk mund të ankimohen.

Neni 29

Anulimi i procedurave të përzgjedhjes

1. Në përputhje me vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë ose urdhrin të drejtorit të përgjithshëm sipas kompetencave përkatëse, procedurat e përzgjedhjes anulohen në këto raste:

a) nëse brenda afatit të përcaktuar nuk janë paraqitur dokumentacione ose oferta nga bankat dhe/ose subjektet;

b) nëse mbi bazë të rezultateve të vlerësimit është marrë vendimi për refuzimin e të gjithë bankave dhe/ose subjekteve për shkak të mosplotësimit të kriterëve.

2. Në rastet e anulimit të procedurave sipas pikës 1 të këtij neni, Këshilli Drejtues i Agjencisë ka të drejtë të vendosë, për:

a) ripërsëritjen e procedurave;

b) nënshkrimin e kontratave në mënyrë të drejtpërdrejtë me një bankë ose subjekt mbështetës të përcaktuar në pikën 1, të nenit 27.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Masat ndëshkimore

1. Agjencia, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të miratuara prej saj nga likuidatori ose punonjësit e subjektit nën likuidim, i propozon Autoritetit Mbikëqyrës marrjen e masave ndëshkimore.

2. Agjencia, në rast shkeljeje të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të miratuara prej saj nga subjektet mbështetëse, zbaton sanksionet e përcaktuara në kontratën e lidhur.

Neni 31

Plani i veprimit për kompensim

Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë miraton, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, planin e veprimit, i cili përmban dokumentet tip dhe procedurën e brendshme operationale të Agjencisë për përgatitjen dhe kryerjen e kompensimit të depozitave.

Neni 32

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Kjo rregullore shfuqizon rregulloren “Për kompensimin e depozitave” dhe udhëzimin “Për procedurat e kompensimit të depozitave të siguruar”, të miratuara me urdhrin të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr. prot. 1827, datë 6.3.2008.



ANEKSI 1 LISTËPAGESA

Për individët

Nr.	Përshkrimi	Koment
1	Kodi unik i depozituesit në bankë/SHKK	Sipas të dhënave në bankën/SHKK-në nën likuidim të detyruar
2	Emri	Emri
3	Atësia	Atësia
4	Mbiemri	Mbiemri
5	Mbiemri përpara martese	Mbiemri përpara martese
6	Gjinia	Gjinia
7	Lloji i dokumentit të identifikimit	1. Kartë identiteti
		2. Pasaportë
		3. Të tjera
8	Numri personal i identifikimit të depozituesit	Numri unik i identifikimit sipas dokumentit të identifikimit
9	Numri i dokumentit të identifikimit	Numri i dokumentit të identifikimit
10	Data e lëshimit të dokumentit të identifikimit	Data e lëshimit të dokumentit të identifikimit
11	Data e skadimit të dokumentit të identifikimit	Data e skadimit të dokumentit të identifikimit
12	Datëlindja	Datëlindja
13	Adresa	Adresa
14	Numri i telefonit	Numri i telefonit
15	E-mail	E-mail
16	Shuma e kompensimit	Shuma totale për t'iu kompensuar depozituesit
17	Data e dërgimit të listëpagesës	Data e dërgimit të listëpagesës

Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

Nr.	Përshkrimi	Koment
1	Kodi unik i depozituesit në bankë/SHKK	Sipas të dhënave në bankën/SHKK-në nën likuidim të detyruar
2	Emri i subjektit	Emri i subjektit
3	Numri unik i identifikimit të subjektit	NIPT
4	Data e regjistrimit të subjektit	Sipas ekstraktit të QKR-së
5	Forma ligjore	TR, SHA, SHPK, SHK, SHKM
6	Adresa	Adresa
7	Numri i telefonit	Numri i telefonit
8	E-mail	E-mail
9	Shuma e kompensimit	Shuma totale për t'iu kompensuar subjektit
10	Data e dërgimit të listëpagesës	Data e dërgimit të listëpagesës

ANEKSI 2

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË SË TË DHËNAVE

Me anë të kësaj shkrese deklarojmë se informacioni i dhënë në formatin standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë u përgatit dhe u paraqit në Agjenci në përputhje me kërkesat e ligjit për sigurimin e depozitave, i ndryshuar, dhe të rregullores për kompensimin e depozitave.

Njësia që e përgatit informacionin dhe njësia që e monitoron këtë informacion sigurojnë vërtetësinë e regjistrimit të transaksioneve dhe se informacioni i dhënë Agjencisë në Formatin Standard të Skedarëve, në dijeninë e tyre më të mirë është i vërtetë dhe i saktë. Sistemet e përpunimit të të dhënave përpunohen me kërkesat e Agjencisë.

ANEKSI 3

PROCEDURA E PAGESËS SË SHUMËS SË KOMPENSIMIT

A. Paga e kompensimit për depozituesit individë

1. Paga e kompensimit kryhet nëpërmjet verifikimit konkret të identitetit të individit, si dhe të dhënave të dokumenteve të identifikimit (pasaportë biometrike ose kartë identiteti) si vijon: emri, mbiemri, numri personal i identifikimit.

2. Pas konfirmimit të identitetit të depozituesit që përfiton kompensim, banka agente, foto-kopjon dokumentin e tij të identifikimit, plotëson të dhënat e munguara në listëpagesë dhe lëshon një vërtetim/mandat për pagesën e kompensimit, në të cilin përcaktohet vlera e parave që tërhiqet ose kalohet në një llogari tjetër bankare. Kopja e këtij



vërtetimi/mandati dërgohet në Agjenci.

3. Me nënshkrimin e vërtetimit nga depozituesi dhe punonjësi përgjegjës kryhet edhe pagesa e kompensimit ose kalon për ekzekutim urdhri për transferimin e parave në llogarinë e përcaktuar nga depozituesi.

4. Në rast të pretendimit të pagesës për kompensim nga i mituri nga 14 deri në 18 vjeç për pagesën e kompensimit, duhet të paraqitet miratimi i përfaqësuesve ligjorë i noterizuar (prindërve, birësuesve, kujdestarëve) për paraqitjen individuale të të miturit për përfitimin e kompensimit.

5. Pagesa e shumës për kompensim në rastet kur përfituesi është i mitur mund të bëhet nëpërmjet transfertës në një llogari tjetër bankare e krijuar nga prindërit apo kujdestarët ligjorë të të miturit në emër të këtij të fundit. Pagesa në ndonjë formë tjetër do të jetë e mundur vetëm pasi të paraqitet vendimi i Gjykatës për lejimin e një veprimi të tillë.

6. Dokumentet e paraqitura nga përfaqësuesi ligjor i të miturit përfitues i depozitës, janë:

a) certifikatë lindjeje e të miturit përfitues i depozitës – për prindërit;

b) certifikatë lindjeje e të miturit të birësuar (bijësuar) – për birësuesit;

c) vendimin e organit të kujdestarisë dhe përkujdesjes për përcaktimin e kujdestarit të të miturit – për kujdestarët;

d) dokumentin identifikues të të miturit.

7. Pagesa e shumës për kompensim për personat me zotësi të kufizuar për të vepruar, përveç atyre të përcaktuar në pikat e mësipërme, si dhe personat që nuk kanë zotësi për të vepruar kryhet vetëm kur jepet miratim me vendim të Gjykatës, me përjashtim të rasteve kur pagesa realizohet me transfertë në llogarinë bankare të këtyre personave në një bankë tjetër.

8. Dokumentet e paraqitura nga përfaqësuesi ligjor i depozituesit, që është me zotësi të kufizuar ose pa zotësi për të vepruar, janë:

a) dokumenti identifikues i depozituesit me zotësi të kufizuar (pa zotësi) për të vepruar;

b) vendimi i organit të kujdestarisë ose përkujdesjes që e njeh depozituesin si person me zotësi të kufizuar (pa zotësi) për të vepruar dhe vendimi për caktimin e kujdestarit.

9. Në rastin kur për përfitimin e depozitës, paraqitet personi i autorizuar, duhet kryer edhe verifikimi i identitetit të personit të autorizuar,

përveç identitetit të depozituesit autorizues. Personi i autorizuar paraqet edhe prokurën origjinale ose kopje të noterizuar. Prokura e përfaqësuesit të depozituesit duhet të përmbajë të dhënat e dokumentit identifikues të depozituesit. Për prokurat e hartuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të vendoset apostili i legalizuar nga përfaqësia diplomatike ose konsullore e Republikës së Shqipërisë, nëse nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjen ndërkombëtare përkatëse. Prokura dhe apostili të hartuara në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohen me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Nëse noteri nuk zotëron aftësi për të përkthyer një gjuhë të përcaktuar në shqip, përkthimi mund të bëhet nga një përkthyes, vërtetësia e nënshkrimit të të cilit noterizohet nga noteri.

10. Pagesa e shumës për kompensim për trashëgimtarët kryhet vetëm nëse paraqitet vendimi i Gjykatës për njohjen e titullit të trashëgimtarit, si dhe vendimin e Gjykatës për ndarjen e trashëgimisë ose marrëveshjen për ndarjen e trashëgimisë në formën e aktit notarial. Nëse në dokumentet e paraqitura nga individët, mungojnë të dhënat identifikuese për depozituesin, të dhënat konsiderohen të vërtetuara nëse të dhënat e listë pagesës përputhen tërësisht me të dhënat e dokumentit të trashëgimisë që vërteton të drejtën e individit për trashëgimi.

11. Në rastet kur titullari me të drejta të plota i depozitës ka vdekur përpara/pas vendosjes së subjektit nën likuidim dhe ky fakt nuk ishte i njohur për likuidatorin në kohën e përgatitjes së listëpagesës, banka agjente nuk kryen pagesën, por kërkon nga Agjencia rishikimin e listës për rastin në fjalë. Agjencia, pasi përcakton listën e personave të autorizuar për tërheqjen e shumës për kompensim, e plotëson atë duke përfshirë në të trashëgimtarët e depozituesit që ka vdekur (*mortis causa*).

B. Pagesa e kompensimit për depozituesit tregtarë dhe shoqëri tregtare

1. Pagesa e kompensimit për depozituesit tregtarë dhe shoqëritë tregtare kryhet nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve vijuese:

a) Ekstraktit origjinal nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të tregtarit/shoqërisë tregtare, i cili mban datë jo më të hershme se 10 ditë nga paraqitja për përfitimin e kompensimit; për subjektet që janë regjistruar jashtë duhet të paraqitet vërtetimi i regjistrimit, i përkthyer dhe i



legalizuar nga shërbimi konsullor i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, i cili mban datë jo më të hershme se 10 ditë nga paraqitja për përfitimin e kompensimit.

b) Certifikata e regjistrimit të tregtarit/shoqërisë tregtare në organin tatimor, që vërtetohet nga noteri për njehsimin me origjinalin jo më herët se 10 ditë nga paraqitja për përfitimin e kompensimit;

c) Autorizimin nga administratori i subjektit për kalimin e shumës së kompensimit në një llogari bankare të tij. Emri i personit që nënshkruan autorizimin duhet të jetë i përfshirë në ekstraktin e QKR-së. Në këtë autorizim përcaktohet detyrimisht IBAN-i dhe emri i saktë i bankës në të cilën do të derdhet shuma e kompensimit.

d) Paraqitjes së të dhënave dhe dokumenteve të identifikimit (pasaportë biometrike ose kartë identiteti) të individit që paraqet autorizimin/formularin për kalimin e shumës së kompensimit.

2. Pas dakordësisë së depozituesit që përfiton kompensim, banka agjente, e pajis atë me dokumentin që konfirmon pagesën në të cilin përcaktohet vlera e parave që kalohet në një llogari tjetër bankare dhe një kopje e këtij dokumenti dërgohet në Agjenci.

3. Pas konfirmimit të identitetit të depozituesit që përfiton kompensim, banka agjente, administron dokumentet e paraqitura, fotokopjon dokumentin e identifikimit të personit të paraqitur, plotëson të dhënat e munguara në listëpagesë, si dhe lëshon një vërtetim për pagesën e kompensimit, në të cilin përcaktohet vlera e parave që kalohet në një llogari tjetër bankare. Kopja e këtij vërtetimi dërgohet në Agjenci.

4. Me nënshkrimin e vërtetimit nga depozituesi dhe punonjësi përgjegjës, kryhet edhe pagesa e kompensimit ose kalon për ekzekutim urdhri për transferimin e parave në llogarinë e përcaktuar nga depozituesi.

5. Me nënshkrimin e dokumentit nga depozituesi dhe punonjësi përgjegjës, kalon për ekzekutim urdhri për transferimin e parave në llogarinë e përcaktuar nga depozituesi.

- Nuk ndikon në rezultatin e verifikimit të të dhënave:

a) Rezultati i verifikimit të këtyre elementeve, si: mbiemri, atësia dhe mbiemri, pranohen nëse nuk përputhen jo më shumë se dy shenja gjatë shkrimit të tyre. Për shembull, Artan – Artin, Mariana – Marjana, Baci – Baçi, Nerenxa – Nerënxa.

b) mospërputhja e shkronjave “e” dhe “ë”, “c” dhe “ç”, “E” dhe “Ë”, “C” dhe “Ç” në shkrimin e emrave dhe mbiemrave;

c) mënyra e shkrimit të emrave (mbiemrave) të dyfishtë, në përputhje me zakonet vendase (për shembull, Paulin at Shtjefni). Në këto raste, mund të përdoren shkronjat e vogla ose të mëdha, të përfshihet ose të hiqet “-” dhe “ ’ ”, të ndryshohet shkronja me qëllim që të përshtatet me një element të përdorshëm të emrit, i cili nënkupton gjininë ose vendin.

6. Banka agjente i bashkëlidh listëpagesës të gjithë dokumentacionin justifikues për kryerjen e pagesës së kompensimit të paraqitur nga depozituesi ose të tretë në emër të dhe/ose për llogari të tij.

ANEKSI 4

KRITERET E KUALIFIKIMIT

1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes të bankave dhe subjekteve mbështetëse

1. Agjencia kualifikon subjektet dhe bankat, nëse ato përmbushin këto kriteret të përgjithshme.

2. Subjektet dhe bankat duhet të dorëzojnë dokumente origjinale ose të noterizuara, të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së procedurës si vijon:

a) vërtetim që banka/subjekti nuk është në proces falimentimi (kujdestarie), (statusi aktiv);

b) vërtetim që banka/subjekti (administratorët e tyre) nuk është dënuar për shkelje penale;

c) vërtetim që banka/subjekti (administratorët e tyre) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional;

d) vërtetim që banka/subjekti ka plotësuar detyrimet fiskale, të lëshuar nga administrata tatimore;

e) vërtetim që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore.

2. Kriteret teknike të vlerësimit Pikët të bankave

i) Numrin e degëve dhe pikave të pagesës dhe veprimet me kasë së bashku me shpërndarjen gjeografike të tyre. [30%]

ii) Aftësitë teknike për kryerjen e pagesave, në veçanti për sistemin IT, i cili të jetë i pajisur me një bazë të dhënash që përditësohet çdo 24 orë, [20%]



mundëson transfertat e drejtpërdrejta elektronike të parasë, si dhe me para në dorë, degët dhe pikat e pagesës *on-line*.

iii) Sisteme efektive kontrolli dhe të auditit të brendshëm për mbrojtjen e veprimeve me *cash*. [15%]

iv) Aftësia për të raportuar në çdo kohë pranë Agjencisë, në veçanti raportimi për paraqitjen unike të depozituesit “Single Customer View”. [10%]

v) Gatishmëria dhe aftësia për të filluar kompensimin e depozitave brenda 2 (dy) ditëve pune pas njoftimit të Agjencisë. [20%]

vi) Gatishmëria për të pritur fluksin e depozituesve dhe për pranimin e dokumentacionit të tyre, kapacitete njerëzore dhe profesionale për të përpunuar ankesat. [5%]

TOTAL (propozimi teknik) 100%

Minimumi i pikëve të propozimit teknik për t'u përfshirë në listën paraprake është 70%.

Fituese përzgjidhet banka agjente, e cila është vlerësuar me maksimumin e përqindjes për propozimin teknik dhe ka paraqitur ofertën ekonomike falas ose me çmimin më të ulët. Në rastin kur dy banka agjente janë vlerësuar me përqindje të njëjta më të larta të propozimit teknik, fituese do të përzgjidhet banka agjente, e cila ka paraqitur ofertën ekonomike falas ose me çmimin më të ulët. Oferta ekonomike paraqitet në vlerë në lekë.

C. Kriteret teknike të përzgjedhjes të subjekteve mbështetëse

Subjektet mbështetëse, kualifikohen, pasi të kenë përmbushur kriteret e mëposhtme, që Agjencia i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe jodiskriminuese:

i) kualifikimi profesional: subjektet paraqesin licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

ii) aftësia teknike: subjektet vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur,

kontrata të ngjashme të shërbimit të kërkuar, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën;

iii) gjendja ekonomike e financiare: subjektet vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të subjektit dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare.

iv) kapacitetet ligjore: subjektet vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Procedura e vlerësimit të bankave dhe subjekteve mbështetëse

A. Vlerësimi për kriteret e përgjithshme dhe teknike

1. Anëtarët e komisionit/njesisë të vlerësimit deklarojnë konfliktin e interesit dhe përmbushin gjatë gjithë procedurës detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit.

2. Komisioni/njësia mban procesverbale dhe dokumentacion për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes, të cilat të përfshijnë, informacion mbi kërkesat për pjesëmarrje dhe ofertat e paraqitura, kontratat e nënshkruara dhe zbatimin e tyre.

3. Zarfet për pjesëmarrje në procedurën e kualifikimit pranohen dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit/njesisë në një ditë të vetme, pas përfundimit të afatit të përcaktuar për dorëzimin e tyre.

4. Zarfet të dorëzuara në komision/njësi përtej afatit të pranimi të tyre, nuk pranohen dhe i kthehen bankës/subjektit përkatës.

5. Nëse komisioni/njësia vëren se banka/subjekti ka mangësi në dokumentacion ata vendosin njoftimin e saj/tij dhe afatin për plotësimin e mangësive. Njoftimi i bankës/subjektit kryhet nga anëtar i autorizuar i komisionit/njesisë. Procesi i vlerësimit pezullohet deri në plotësimin e dokumentacioneve sipas njoftimit të komisionit/njesisë.

6. Komisioni/njësia vlerëson dokumentet e dorëzuara nga banka/subjekti, për përputhshmërinë e këtij dokumentacioni me kërkesat për kualifikim.



7. Si rregull, afati i shqyrtimit të dokumenteve përcaktohet nga komisioni/njësia. Ky afat mund të shtyhet sipas vendimit të komisionit/njesisë duke njoftuar Këshillin Drejtues të Agjencisë/drejtorin e përgjithshëm.

8. Banka/subjekti që nuk i plotëson kriteret, skualifikohen dhe njoftohen për këtë skualifikim brenda shtatë ditësh nga marrja e vendimit.

B. Skualifikimi

1. Agjencia skualifikon çdo bankë/subjekt, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese.

2. Agjencia përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e përzgjedhjes çdo bankë/subjekt, kur ka të dhëna se janë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;
- b) korrupsion;
- c) mashtrim;
- d) pastrim parash;
- e) falsifikim.

3. Agjencia mund t'i kërkojë çdo banke/subjekti, të paraqesin dokumente dhe, kur ka dyshime, mund t'u drejtohet organeve kompetente për të marrë informacionin e nevojshëm për integritetin dhe gjendjen financiare të subjekteve në fjalë.

4. Vendimi për skualifikimin mund të merret nga Agjencia edhe në rast se:

a) banka/subjekti (ose stafi i tyre) shkelin ligjin për sigurimin e depozitave, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi;

b) ka mospërputhje së bankës/subjektit me kriteret dhe kërkesat e Agjencisë të evidentuar gjatë verifikimit dhe raportimit;

c) banka/subjekti nuk ka përmbushur në mënyrë të kënaqshme kontratat e mëparshme me Agjencinë.

5. Vendimi për skualifikimin e bankës/subjektit merret nga Këshilli Drejtues i Agjencisë/drejtorin e përgjithshëm sipas propozimit të komisionit/njesisë të vlerësimit. Njoftimi për këtë i dërgohet bankës/subjektit jo më vonë se 7 ditë pune nga data e marrjes së vendimit përkatës.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4774, datë 7.7.2016, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Denis Jangulli, i biri i Avniut dhe i Nailes, i datëlindjes 23.1.1985, lindur në Dibër, Peshkopi, dhe me vendbanim në Tiranë, si dhe caktimin si kujdestare të pasurive të tij, bashkëshorten e tij, Joana Llozhi.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë